

Dr. Jahja Drançolli

**NDIKIMET E NDËRSJELLA KULTURO-SHOQËRORE
E RELIGJIOZE NDËRMJET RAGUZËS DHE KOSOVËS
GJATË SHEKUJVE XIV — XV**

Që nga periudha antike dhe në periudhat e mëtejme historike Kosova shtrihet në udhëkryqin e dyndjeve e të ndikimeve që vinin nga Lindja dhe Perëndimi, herë pas here edhe nga Veriu dhe Jugu. Po ashtu, pozita e mirë gjeografike dhe pasuritë e mëdha natyrore të Kosovës mesjetare tërhiqnin vëmendjen e shumë tregtarëve italianë dhe të qyteteve të bregdetit jugosllav, në radhë të parë raguzanë dhe venedikas. Meqë Ragusa ishte vazhdimisht në marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e dinastisë nemanjiqe dhe Kosova ishte atëbotë në kuadrin e zotërimeve të tyre, është e natyrshme që raguzanët qenë të privilegjuar jo vetëm të zhvillonin tregtinë në këtë anë, por të ishin edhe pjesëmarrës dhe ndërmjetës për bartjen e kulturës italiane dhe asaj bregdetare jugosllave. Ky ndikim është ndier në tërë krijimtarinë kulturore të qyteteve mesjetare të Kosovës, në radhë të parë në artet figurative (arkitekturë, skulpturë dhe pikturë) dhe në mjekësi. Po ashtu, në disa momente historike, në radhë të parë nëpërmjet raguzanëve, u ndie ndikimi i frymës ideologjike përendimore, që u manifestua në formë të religjionit, përkatësisht në formë të ndikimit të kishës dhe të dogmës katolike.

1. Ndikimet në artet figurative

Në Kosovë, si dhe në tërë territorin e Jugosllavisë, duke filluar nga periudha parahistorike e deri në ditët tona, rrjedh vazhdimësia e jetës njerëzore, ndërsa formacionet etnokulturore, qytetërimet e popujt u kanë lënë trashëgimi pasardhësve shumë të dhëna për vlerat kulturore. Kosova paraqet një burim të begatshëm të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme, të cilat veçohen nga vlerat, cilësitë, llojlojshmëria, rëndësia historike e tyre.¹

¹ F. Drançolli, *Kulla si banesë shqiptare në rrafshin e Dukagjinit*, (tema magjistrature), Prishtinë, 1983, f. 17.

Në fondin e këtyre veprave të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore bëjnë pjesë edhe objektet sakrale, të kultit, të realizuara në periudhën mesjetare, përkatësisht në kohën kur territori i Kosovës ishte nën sundimin e shtetit mesjetar serb.

Gjatë sundimit të Nemanjës, shteti serb i Rashës u zgjerua deri në bregdetin adriatik. Periudhën e Nemanjës, si dhe të pasardhësve të tjerë të tij, e karakterizojnë një numër i madh ndërtime sakrale, monumentale. Për këto ndërtime sakrale, kisha monumentale, ishte e nevojshme të ekzistonte edhe një bazë e fortë ekonomike. Nemanja dhe pasardhësit e tij kishin mundësi ekonomike të krahasoheshin edhe me fqinjët dhe kështu, pas shembullit të tyre, të ndërtonin objekte sakrale, manastire, kisha monumentale.

Në ecurinë e vet interesante arti i bregdetit ka ndjekur si tërësi rrjedhat e përgjithshme të artit evropian perëndimor, të cilin dhe i takonte në themel të vet. Pra, gjatë shekujve arti bregdetar dalmatin u zhvillua kryesisht në suazat e Perëndimit. Në artin e territorit në fjalë dalin objekte të stileve: pararomanik, romanik, gotik, iluminist dhe të barokut.²

Duke u gjendur në zona kufitare mes Lindjes dhe Perëndimit, ku ndesheshin dhe plekseshin me shekuj ndikimet e dy kulturave, bregdeti përpiqej shpesh të krijonte vepra që pajtonin në vete natyrat e tyre të largëta.³

Si në fillim, ashtu edhe gjatë fazës së pjekurisë, ndërtimtaria romanike bregdetare u zhvillua edhe nën ndikimin e fortë të Gadhullit të Apenineve. Përveç elementeve të Apulisë, ndikimi dhe veprimtaria e së cilës vërehen në bregdetin jugor, sidomos në Raguzë, këtu në këtë rajon të Adriatikut, dalin edhe elemente të reja të Italisë së Mesme, përkatësisht të Lombardisë.⁴

Në shekullin XIV në artin bregdetar dalmatin shfaqen edhe elemente të kulluara të gotikës. Elementet e cekura të stilit romanik, si dhe të atij gotik, i sollën urdhrat kishtarë, benediktinët, françeskanët dhe domenikanët, nga Italia.⁵

Duhet theksuar se në bregdetin jugor të Adriatikut në veprimtarinë figurative vërehen edhe ndikime bizantine, të shprehura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthoratë.⁶

Sa i përket lidhjeve ndërmjet shtetit serb dhe Perëndimit, bregdeti ka luajtur rol të tërthortë në përhapjen e ndikimit të artit Perëndimor. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ishte edhe mënyra e vetme e përhapjes së ndikimit Perëndimor, meqë mund të jetë mundësia që elementet perëndimore të jenë paraqitur pa ndërmjetësimin e bregdetit. Supozohet se Helena e Anzhuinëve (grauja e Uroshit I) u angazhuan të sillte mjeshtër të huaj në disa ndërtime sekrele.⁷

² Subotić, *Arhitektura i skulptura srednjeg veka u primorju, Beograd, 1963, 6*; Lj. Karaman, *Pregled umetnosti u Dalmaciji, Zagreb 1952, 8*.

³ Lj. Karaman, *vepër e vituar, 8, 48*.

⁴ Lj. Karaman, *vepër e cituar, 48*.

⁵ Lj. Karaman, *vepër e cituar, 8, 33, 43*.

⁶ Lj. Karaman, *vepër e cituar, 8, 48*.

⁷ Lj. Karaman, *vepër e cituar, 77*.

Elemente perëndimore, bregdetare, dalmatine, të stilit romanik, romaniko-gotik e deri diku gotik, dalin edhe në disa objekte të karakterit sakral, të ndërtuara gjatë mesjetës në Kosovë.

Në këtë periudhë, përkatësisht në shekullin XIII, veçanërisht në shekullin XIV, në territorin e Kosovës u realizua një numër i manastiresh, kishash monumentale, ku shfaqen ndikimet që u zunë ngoje më lart. Në fillim të shekullit XIII u ndërtua Kisha e Apostojve të Shenjtë në Pejë.⁸ Në të vërtetë, kjo kishë është, me sa duket, një rikonstruim i një ndërtimi më të vjetër, të cilit iu dha forma e Kishës së Zhiçës. Ndërtimit në fjalë iu konstruktuan kubeja, altari me kthinat anësore. Në fasadat e kësaj kishe me një anijetë vërehet edhe mënyra romanike e punimit, stili në të cilën u realizuan objektet sekrale, kishat në Evropën Perëndimore, në Italinë Jugore dhe në bregdetin jugosllav. Kisha e Apostojve të Shenjtë në Pejë u ndërtua në mënyrë dhe nën ndikimin bregdetar, me gurë të imët dhe të gdhendur.⁹

Ndikimet perëndimore, posaçërisht ndikimi i Kotorrit, Tivarit dhe Raguzës në zhvillimin e arkitekturës dhe të skulpturës që u zhvilluan në Kosovë gjatë periudhës mesjetare, vërehen më së miri në këto ndërtime monumentale të kultit: në Banjskë (Mitrovica e Titos), vepër e realizuar gjatë kohës së mbretit Milutin (1312—1318); në Deçan, ndërtuar gjatë sundimit të mbretërve Stefan Deçani dhe Dushan (1327—1335), dhe e kryengjejve Mihal dhe Gabrel (në Prizren), ndërtim i perandorit Dushan (1347—1352).

Nga se u tha më lart, shihet se këto tri manastire me kisha monumentale të kultit u ndërtuan në gjysmën e parë të shekullit XIV, në periudhën kur në bregdetin dalmatin dalin tashmë edhe elemente të kulluara të gotikës. Në monumentet e sipërpërmendura kishtarë shfaqen elemente të stilit romanik, romaniko-gotik dhe gotik. Këto ndikime bregdetare arrijnë në hinterlana nëpërmjet lidhjeve që kishte shteti mesjetar serb me bregdetin. Elementet e stilit romanik, romaniko-gotik dhe gotik përfaqësohen në portale, dritare, ancarë, kapitale, pra, si në realizimin arkitektonik, ashtu në atë plastik, skulptural.

Është për t'u theksuar për ilustrim se Katedralja e rindërtuar e Kotorrit, në shekullin XIV u bë edhe me dritaren tripjesëshe triforium, e cila është e ngjashme me atë të Manastirit të Deçanit, të cilën e realizoi kryemjeshtri dom Vita.¹⁰ Kjo e dhënë në një mënyrë na mundëson të flasim për një ndikim të ndërsjellë ndërmjet hinterlandit dhe bregdetit. Triforja e Deçanit është realizuar nën ndikimin e triforës së Kishës së Studenicës.

⁸ A. Deroko, *Monumentalna i dekorativna arhitektura u srednjovekovnoj Srbiji*, Beograd, 1953, 77.

⁹ A. Deroko, *vepër e cituar*, 60, 61, 77.

¹⁰ Për origjinën e dom Vita nuk ka shumë të dhëna, dihet se një kohë ka jetuar dhe vepruar në Kotorr. Ka të ngjarë, sipas një të dhëne të Arkivit Historik të Kotorrit, të ketë qenë rektor ose kryemurg i Kishës së Shën-mërisë (dominus Vita, rector ecclesie s. Marie). Po ashtu ka të dhëna se dom Vita me 30 gurskalitës ndërtoi Manastirin e Deçanit (1328—1335) — shiko, AHK, SN I/1, f. 3; Lj. Karaman *vepër e cituar*, f. 43.

Në ndërtime sakrale të bregdetit adriatik ka pasur ndërtime monumentale me kube (ndërtim bizantin), një numër i të cilave është rrënuar. Kështu, në këtë mënyrë ishte e ndërtuar Katedralja e Shën Mërisë në Raguzë. Kjo vepër monumentale e karakterit sakral njihet vetëm në saje të paraqitjeve figurative. Kjo Katedralja është rrënuar në tërësi nga termeti i vitit 1667. Pamjen e përgjithshme të kësaj vepre monumentale na e përkujton Manastiri, përkatësisht Kisha e Deçanit. Kjo Kishë, me dimensione monumentale, paraqet një sintezë të tipit bazilik me zgjedhje të ndërtimit të ashtuquajtur kryq i shkruar me kube.¹¹

Kisha e Manastirit të Deçanit është vepra më e madhe që ruan elemente nga ndërtimtaria e bregdetit jugor.¹² Në arkitruan e portalit jugor të narkeksit gjendej edhe një mbishkrim i gdhendur i kryemjeshtrit dom Vita »nga Kotorri qytet i mbretërve«. Duhet theksuar se emri i këtij mjeshtri nga Ravena del edhe në një dokument të përpiluar në pallatin serb, nga i cili shihet se dom Vita i njihte mirë rrethanat në Kotorr, ku, si duket, edhe ka jetuar. Në mbështetje të kësaj të dhëne, mund të lidhen edhe elementet e afërta të planit të Kishës së Deçanit me atë të Portonovës, afër Ankonës.¹³ Mirëpo, pa marrë parasysh këtë, gjithsesi sistemi konstruktiv dhe format dekorative të Deçanit, në mungesë të përmendoreve të tjera, flasin për aftësitë e ndërtuesve kotorres në periudhën në fjalë, ku stili gotik në arkitekturë nuk kishte mbizotëruar në tërësi mbi format e ndërtimit të vjetër. Njëherazi duhet theksuar se gotika me elementet e saj të kulluara nuk paraqitet në bregdetin jugor si në bregdetin dalmatin.¹⁴

Tradita shekullore e skalitjes së gurit dhe jeta në suazat e shtetit serb të nemanjiqëve mundësuan që në bregdetin e Zetës, në shekullin XIV, të lulëzonte skulptura. Punëtoritë dhe një numër i madh mjeshtrish nuk vepruan vetëm në Kotorr, Tivar, Ulqin, por edhe në Raguzë, Split dhe Trogir, si dhe në Serbi e Bosnjë. Këta gdhendës u aftësuan aq, saqë mjeshtrinë e ngriten në nivel të skulpturës artistike. Kjo skulpturë e shekullit XIV, fatkeqësisht, nuk është ruajtur dhe aq shumë (përveç në Kotorr), e cila ndikoi dukshëm në zhvillimin e skulpturës së shkollës së Rashës,¹⁵ së cilës i takuan territorialisht edhe objektet kishtarë të ndërtuara në shekullin XIV në Kosovë. Për fat të keq, nga këto objekte me dekorime plastike kanë mbetur në tërësi Manastiri i Deçanit, Kisha e Shën Dhimitrit dhe ajo e Zonjës së Bekuar në kompleksin e Patrikanës së Pejës.

Të kthehmi në disa objekte të shekullit XIV në Kosovë, më skulpturën e të cilave hasim ndikime në përgjithësi të Adriatikut, në veçanti të Kotorrit dhe të Raguzës. Ndonëse Kisha e Shën Prentes në Prizren nuk është e pasur me skulpturë, prapëseprapë aty dalin motive, gjethet, lulet, hardhia, që janë karakteristike për de-

¹¹ L. j. Karaman, *vepër e cituar*, 52, 53.

¹² L. j. Karaman, *vepër e cituar*, 78.

¹³ L. j. Karaman, *vepër e cituar*, 78.

¹⁴ L. j. Karaman, *vepër e cituar*, 79.

¹⁵ J. Maksimović, *Srpska srednjovekovna skulptura*, N. Sad, 1971, 83.

korimin guror të Deçanit. Plastika paraqet një punë solide mjesh-tërrore. Po ashtu në Banjškë, në aspektin artistik arkitektural dhe skulptural, shfaqet një sintezë e konceptit bizantin dhe perëndi-mor. Sinteza të elementeve bizantine dhe perëndimore në plastikë kemi edhe në kompleksin e Patriakanës së Pejës, në Kishën e Shën Dhimitrit dhe të Zonjës së Bekuar të ndërtuara rreth viteve 1320—1330).¹⁶

Elementet bizantine, romanike, romanike-gotike dhe gotike në skulpturë nga prezentohen më së miri në Kishën e Deçanit, vepër e realizuar nga mjeshtër bregdetarë, përshtatur kushteve dhe nevojave të porositësve. Në këtë skulpturë janë prezentuar eleme-nte të skulpturës bashkëkohore të skulpturës së Kotorrit, Tivarit dhe të Raguzës.¹⁷ Skulptura e Deçanit është një realizim hetero-gjen, ku shfaqen rryma të ndryshme artistike, bizantino-romanike të Studenicës, romanike-gotike dhe detaje të gotikës së kulluar të huazuar nga bregdeti.¹⁸

Edhe në skulpturën e Kryengjësve në Prizren, sikurse në De-çan, Banjškë, Pejë, dalin elemente të stilit romaniko-gotik. Kjo skulpturë e shek. XIV që shfaqet në Kosovë, posaqërisht në De-çan, gërshetohet me koncepte afërsisht të njëjta, të paraqitura edhe në bregdetin adriatik Apuli, Abruçe dhe Venedik.¹⁹

Ndikimi bizantin dhe i perëndimit na del edhe në pikturë. Në këtë gjë ndikuan mjeshtrit që arritën nga bregdeti, ku ata ishin në kontakt me artin perëndimor (italian), të cilin e aplikuan në punimet e veta. Në pikturimin e afreskëve të Deçanit punuan jo vetëm mjeshtrë ortodoksë, por u realizuan edhe nga mjeshtrë të kulturës latine. Afreskat e Deçanit i dekoruan mjeshtrë nga Ko-torri, piktorë këta që, duke vazhduar traditën e punëtorive të vje-tra bregdetare, punuan sipas »manirit grek«.²⁰

Nga se u tha më lart, mund të konstatohet se artet figura-tive, përkatësisht arkitektura, skulptura dhe në një masë edhe pik-tura, paraqesin një simbiozë të elementeve Lindore dhe Perëndi-more, të ardhura nëpërmjet Kotorrit dhe Raguzës, të cilat u modi-fikuan dhe iu përshtatën rethanave të artit të zhvilluar në Koso-vë gjatë periudhës mesjetare.

Përveç në objekte sakrale, ndikimi raguzano-bregdetar vëre-het edhe në objekte profane (publike). Pasi tregtarët raguzanë ki-shin vërshuar në qytetet e Kosovës, pamja e disa qyteteve, sido-mos e tregut dhe e dyqaneve, filloi të merrte formën e tipit breg-detar. Por një ndikim i këtyllë vërehet në radhë të parë në zhvi-llimin e qyteteve, ku vepronin raguzanët. Në shumë tregje të qy-teteve të Kosovës mesjetare, në gjysmën e parë të shekullit XV (në Prizren një shekull më parë), vërehen dyqane të tipit ragu-zan. Raguzanët posedonin edhe shtëpi, madje ka pasur edhe lagje

¹⁶ J. Maksimović, *vepër e cituar* 96, 99.

¹⁷ J. Maksimović, *vepër e cituar*, 106.

¹⁸ J. Maksimović, *vepër e cituar*, 107.

¹⁹ J. Maksimović, *vepër e cituar*, 107, 112.

²⁰ S. Radojčić, *Staro srpsko slikarstvo*, Beograd 1966, 130, 136.

të tëra me banorë raguzanë, si, bie fjala, lagja raguzane në Prizren. Pamja arkitekturale e tyre u ngjante shtëpive raguzane.²¹

Është për t'u theksuar se e tërë krijimtaria raguzane në fushën e arteve figurative në Kosovë nuk është ruajtur fare. Janë ruajtur vetëm burime të shkruara historike të regjistruara në ndonjë libër të Arkivit Raguzan. Në këtë drejtim ne do t'i zëmë ngoje disa artistë raguzanë, të cilët vepruan në qytetet e Kosovës dhe kontribuan për ngritjen e arteve figurative të Kosovës mesjetare. Dihet se »Stefani Zorneia« në vitin 1463 punoi një ikonë për Kishën e Shën Nikollës në Novo-Bërdë. Ndërkaq, së bashku me Johannes Ognenouichin, në vitin 1461 realizoi poliptikun e Kishës së Shën Nikollës.²² Stefanin e angazhoi edhe plegani i Kishës së Shën Pjetrit në Trepçë. »Stefan Zorneia« është dashur ta realizonte altarin dhe poliptikun me 14 figura me brendësi të artë, të kuadrura në kornizë të praruar dhe të gdhendur. Në pjesën e poshtme të pikturës së altarit janë paraqitur figurat e Zonjës së Bekuar me Krishtin të rrethuar nga engjëj. Ndërkaq, në radhën e epërme paraqitet vetëm pjesa e epërme e trupit të shenjtorëve. Përreth paraqiten skena nga jeta e Shën Nikollës.²³

Ndonëse, sipas një urdhri të Qeverisë raguzane të vitit 1302, mjeshtrit raguzanë pengoheshin të dilnin jashtë qytetit për të vepruar në qytete të tjera, disa mjeshtër, duke shfrytëzuar lejen që kishin marrë nga konsulli dhe Këshilli i Madh Raguzan, vepronin në disa raste edhe jashtë Raguzës.²⁴

Sipas rezultateve të gjertanishme, të mbështetura në materialet e Arkivit të Dubrovnikut dhe të Kotorrit, mund të konstatohet se Raguzë ka pasur lidhje më të afërta artistike me Kotorrin. Kjo e dhënë ilustron më së miri nga identiteti i monumenteve artistike në qytetet e përmendura.

Mjeshtrit raguzanë të arteve figurative vinin në qytete të Kosovës edhe për qëllime tregtare. P.sh., Millosius Joannis pictor, nxënës i mjeshtrit të njohur Fransischo nga Bolonja, në gjysmën e parë të shekullit XIV e ndeshim duke bërë tregti në Novobërdë. Është për t'u theksuar se Millosius është marrë më tepër me punë tregtare sesa artistike.²⁵

Nga testamenti i Miletha Crancouich, të përpiluar në vitin 1463, mësojmë se ai lë 100 perperë me qëllim që të blihej një ikonë për ta dërguar si dhuratë për Kishën e Shën Nikollës në Novobërdë.²⁶

²¹ HAD, *Lamenta de foris XI*, f. 75; XII, 72; *Lettere et commissione Lavantis IX*, f. 167 dhe në shumë vende të librave të Këshillit të Vogël Raguzan.

²² HAD, *Diversa Cancellariae LXXI*, 67v; *Diversa Notariae XLIV*, 72; I. Tadić, *građa o slikarskoj školi u Dubrovniku XIII—XIV v.* f. 216—217.

²³ HAD, *Diversa Notariae LXVII*, f. 168; J. Tadić, *Građa o slikarskoj školi*, 305—306.

²⁴ C. Fisković, *Prvi poznati dubrovački graditelj*, Dubrovnik 1955, 85.

²⁵ HAD, *Acta Consilii Minoris II*, f. 4v, 88; III, f. 121v; J. Tadić, *Građa o slikarskoj školi*, 119, 132, 134, 187.

²⁶ HAD, *Diversa Notariae LXVII*, f. 3v.

Është për t'u theksuar se përveç mjeshtërve raguzanë të arteve figurative, të cilët, me paraqitjen e vet në Kosovë ose nga ndonjë vend tjetër, ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë në kulturën artistike kosovare, ka pasur edhe mjeshtër kosovarë, të cilët vepruan në Raguzë. Disa prej tyre, madje, hynë edhe në radhët e elitës së krijuesve raguzanë. Në këtë drejtim në radhë të parë duhet të zihet ngoje piktori novobërdas Johannes Oggnenouich.

Johannes Oggnenouich ishte ndër piktorët dhe pjesëmarrësit më të njohur të shkollës së pikturës raguzane të shekullit XV. Meritat e tij artistike ngrihen edhe më, kur merret parasysh fakti se dy fëmijët e tij, Pjetri dhe Pali, si dhe nipi i tij Gjoni, ishin piktorë të merituar. Moshën rinore Johanni e kaloi në Novobërdë aty rreth viteve dyzet të shekullit XV, ndërkaq, braktis vendlindjen dhe shkon në Raguzë.²⁷ I pasuruar nga trashëgimia, Johanni kishte mundësi ta ngrinte një dyqan dhe t'i mësonte aty nxënës të rinj me aftësitë e veta zejtare dhe artistike.²⁸

Gjatë viteve të para të qëndrimit të vet në Raguzë, Johanni bëri përpjekje të inkuadrohej në çështje komunale, mirëpo Këshilli i Madh në tubimet e veta kishte vendosur ta pranonte piktorin Marinus Barbar.²⁹ Prej asaj kohe e deri në fund të dhjetëvjetshit të pestë të shekullit XV, në dyqanin e vet në Raguzë Johanni merret me punimin e arkave të drunjta dhe të krevateve të tipit »hungarez«. ³⁰ Johannes Oggnenouichi nuk e njihte mirë teknikën e bojatisjes dhe për këtë ai bën kontratë me piktorin më të njohur të Raguzës, Johannes Zorneon, i cili gjatë tërë jetës duhej t'i pikturonte arkat e tij të punuara me material druri.³¹ Për qëllime identike Johanni, në vitin 1442, pranon në dyqanin e vet Micoç Raianouichin,³² ndërsa në vitin 1449 piktorin Damianus Johannus.³³

Duke pasur aftësi të një mjeshtri të specializuar për punimin e drurit, me iniciativë të funksionarëve të angazhuar për mbikëqyrjen e meremetimit të pallatit të princit, Johannes Oggnenouich dërgohet në Kotorr me qëllim që të bënte zgjedhjen e drurit për nevoja të përmendura. Në vitin 1449 ai bën përpjekje edhe një herë të pranohej në punë komunale, për mjeshtër, lidhur me punimin e mburojave të vogla dhe të mëdha, si dhe të barotit për bombardat dhe pushkë, për prodhimin e salnitres, për punimin e arkave metalike dhe të arkëzave »hungareze«. Tërë kjo

²⁷ J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, V, 94, 241, 291; HAD, *Diversa Notariae XIX*, f. 134–134v; *LI*, f. 189; *Diversa Cancellariae LV*, 33v; *LXXX*, f. 3, dhe në shumë vende të librave të Arkivit të Dubrovnikut.

²⁸ HAD, *Diversa Cancellariae LV*, f. 127; *LVI*, f. 32, 131v 186v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 113, 120, 122, 125, etj.

²⁹ HAD, *Acta Consilii Maioris VII*, f. 70, 70v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 128.

³⁰ HAD, *Diversa Cancellariae LVIII*, f. 121v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 141.

³¹ HAD, *Diversa Cancellariae LVI*, f. 186v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 125–126.

³² HAD, *Diversa Cancellariae LVI*, f. 32; J. Tadić, *Grada*, 120.

³³ HAD, *Diversa Notariae XXXIV*, f. 163v; J. Tadić, *Grada*, 172.

flet bindshëm për ambiciet e mëdha të Johannit për t'u angazhuar në punë komunale-shtetërore.³⁴ Që të mund të angazhohej në këtë drejtim, ai është dashur ta ndërronte deri diku edhe orientimin profesional.

Gjatë viteve 1450—1475 Johanni ishte vazhdimisht në detyrë të Republikës së Raguzës. Atëbotë ndryshimet në teknikën ushtarake e detyruan Johannes Ognenouichin të merrej tërësisht me profesion tjetër. Nga piktor dhe punues i arkave dhe i mburojave kalon në punë si mjeshtër i armëve të zjarrit dhe i arkave metalike.³⁵

Johannes Ognenouich, ndonëse i angazhuar në detyrë të komunës, gjente mundësi të punonte kohë pas kohe për porosities e interesuar për mjeshtërinë e tij lidhur me përpunimin e veglave prej druri. Ndërkaq, në anën tjetër, së bashku me piktorin Stefani Zorneo (birin e piktorit Johannes Zorneo) dhe me birin e tij Pjetrin punon në dekorimin e kishave të Raguzës dhe më gjerë. Sidomos është shquar në pikturimin e altarëve dhe në draperi. Johanni ishte shumë i kujdesshëm dhe i zellshëm në punë dhe këtë veçori e ruajti deri në vdekje (vdiq aty rreth viteve 1478—1482).³⁶

Cilësitë dhe aftësitë mjeshtërore të Johannit i kanë vijuar fëmijët e tij. Të tre fëmijët e tij, duke filluar nga i madhi, Pjetri, kishin dituri komplete nga fusha e arteve (pikturë). I madhi (Pjetri), si i ri, më dëshirë të babait shoqërohej me piktorin Stefani Zorneo, birin e piktorit të mirënjohur të Raguzës Johannes Zorneo. Në dyqanin e Pjetrit kanë mësuar shumë raguzanë dhe të huaj. Është për t'u theksuar se aty mësoi një kohë piktori i njohur i Raguzës me origjinë nga Kotorri, Nicolaus Bosidarouich de Catharo.³⁷ Shkathësinë e vet artistike Pjetri e ka shprehur më tepër në pikturimin e sipërfaqeve të arkave dhe të stolive të ndryshme, mirëpo kohë pas kohe ka hyrë edhe në shërbim të pikturimit të poliptikëve në altar. Vëllai më i vogël i Pjetrit, Pali, po ashtu ishte piktor. Ndonëse më vonë merret në mënyrë aktive me tregti, administruesit e Republikës së Raguzës e vinin shumë shpesh para emrit të tij atributin »piktor«.³⁸

Johannes Ognenouich kishte dëshirë që edhe Vllahun, birin e tretë, ta orientonte në pikturë, madje ta aftësonte sa më mirë. Për këtë qëllim fton piktorin e njohur raguzan me origjinë nga Kotorri Magister Laurentius Dobruscus de Catharo.³⁹ Mirëpo, Vllahu kishte dëshirë t'i vijonte mësimet në shkollë fetare dhe pasi i

³⁴ HAD, *Diversa Cancellariae LVII*, f. 108; *Acta Consilii Maioris IX*, 69v; J. Tadić, *Grada*, 133, 171.

³⁵ J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 176—262.

³⁶ HAD, *Diversa Notariae XLIV*, f. 29, 72v; *CXLIV*, f. 84v; *LI*, f. 189, *LXXI*, f. 67v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 176—262.

³⁷ HAD, *Diversa Notariae XLIV*, f. 29; *CXLIV*, f. 84v; *XLIV*, f. 91; *XLVI*, f. 105v; *XLVII*, f. 60; *LI*, f. 189; *LX*, f. 121; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 214, 218, 221, 223, 224, 241, 246, 270, 271, etj.

³⁸ HAD, *Diversa Cancellariae LXXX*, f. 3; *LXXXIII*, 46v; *Diversa Notariae LXXII*, f. 30; *Procura Notariae VIII*, f. 224, 260v; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 291, 297, 318, 322.

³⁹ HAD, *Diversa Cancellariae LXXVI*, f. 138; J. Tadić, *Grada o slikarskoj školi*, 261.

kreu ato, u emërua prift. Dëshirën dhe dijeninë artistike në lëmin e pikturës e ka shfaqur edhe brezi i ri i kësaj familjeje. Kështu, familja Oggneuich i dhuroi artit dhe shkollës raguzane tre breza të piktorëve të vyer.

Johannes Oggneuich, ndonëse nuk ka lënë ndonjë vepër të madhe, me punën e vet të vyer dhe të palodhur ai ka lënë gjurmë të një krijimtari origjinale. Dituria dhe talenti i tij ishte freski për shumë piktorë të njohur të Raguzës dhe më gjerë. Se sa çmohet vlera artistike e tij, vërehet më së miri se të gjitha kronikat si dhe librat zyrtarë të kohës e ngrenë atë në qarqet të artistëve më të mirë të Raguzës, siç ishin piktorët e familjeve Dobruscus, Hamziq, Zorneo etj.

Një shekull më parë, përkatësisht nga mesi i shekullit XIV, në Raguzë veptoi edhe artisti prizrenas »trumbeta« Dragan.⁴⁰

Nga sa u tha më lart, mund të konstatohet se veprimtaria e disa artistëve kosovarë në Raguzë bëri që edhe arti i Kosovës mesjetare të ndikonte sadopak edhe në Raguzë.

2. Ndikimet në mjekësi

Gjatë shekujve XII—XV mjekësia në Kosovë ishte në ngritje të pandërprerë. Mirëpo, këtu dhe më gjerë nuk pati ndonjë zbulim me karakter të përgjithshëm mjekësor.⁴¹

Lidhur me shkencat mjekësore praktike në Kosovë gjatë mesjetës, sidomos gjatë shekujve XII—XV, mund të thuhet se ato u zhvilluan kryesisht sipas mjekësisë perëndimore të kohës. Ndërkaq, shkencat ndihmëse të mjekësisë ishin më tepër nën ndikimin e mjekësisë bizantine. Në esencë, mjekësia që zhvillohet në Kosovë dhe më gjerë ishte ajo e Hipokratit, Galenit, Aristidit dhe e mjekëve të tjerë antikë. Mjekësia klinike e Hipokratit ishte shpesh nën ndikimin e mjekësisë religjioze dhe si e tillë nuk mund t'i zhvillonte shkencat themelore mjekësore (anatominë dhe fiziologjinë). Kështu, kjo mjekësi nuk ka dhënë asnjë ide ose risi, përveç përshkrimit të mësimit të mjekëve antikë.⁴² Një konkludim i kësaj vërtetohet edhe nga fakti se edhe patologjia qëndronte mbi themelet e mjekësisë antike, e cila është bazuar vetëm në ndryshimin në lëngje. Ky ishte edhe shkaku kryesor për rëndësinë parësore që i jepej gjendjes së urinës dhe ndryshimeve në shtresat e saj. Ndërkaq, parim themelor terapeutik ishte contraria contrariis curantur, duke menduar se sëmundja evitohet me lëshimin e gjakut. Ndërhyrjet kirurgjike kufizoheshin vetëm me kirurgji të thjeshtë, me shërbimin e lëndimeve, frakturave, prerjen e abscesit (abscessus), herniotomi dhe ndonjëherë bënin edhe trepanacion. Në të shumtën e rasteve, për shkak të infeksionit dhe mosqepjes së plagës, operacioni merrte fund me vdekjen e pacientit.

⁴⁰ K. Jireček, *Istoriya Srba II*, 295.

⁴¹ J. Drançolli, *Shërbimi mjekësor në Kosovë gjatë mesjetës*, »Rilindja«, 12. VI. 1982, f. 12.

⁴² J. Drançolli, *Shërbimi mjekësor në Kosovë*, 12.

Situatë identike ishte edhe në gjinekologji. Pas çdo lindjeje të vështirë, lehonës i shuhej jeta, gjë që shkaktohej nga sepsisi.⁴³

Deri vonë në historikun mjekësor ka ekzistuar mendimi se pjesët jugore dhe lindore të Ballkanit ishin nën ndikimin e drejtpërdrejtë të mjekësisë bizantine. Mirëpo, dokumentet arkivore të kohës, të ruajtura në Arkivin Historik të Dubrovnikut dhe në Arkivin Historik të Kotorrit, japin pasqyrë tjetër. Ato dëshmojnë se në trojet e përmendura, pra edhe në Kosovë, vinin mjekë dhe farmaceut nga Raguzi, të cilët kishin origjinë italiane.⁴⁴

Numri më i madh i akteve, shkrimeve, dokumenteve për zhvillimin e mjekësisë shkencore në trojet ballkanike gjatë periudhës mesjetare është ruajtur në kodeksin mjekësor të Hilandarit. Në këtë kodeks hasim në të dhëna nga fusha e patologjisë, terapeutikës, farmakologjisë, toksikologjisë, sëmundjeve ngjitëse etj.⁴⁵

Për shkathtësi kirurgjike janë dalluar kirurgët që vinin nga bregdeti. Në shekullin XV, në trojet që hynë nën studimin osman, mjekësia ra në dekadencë. Ardhja e osmanëve në Ballkan, përveç të këqiave të njohura historike, solli më vete edhe epidemi të shumta, si, bie fjala, murtajën, tifonë, leusin etj. Këto epidemi, bashkë me leprën (gërbulën), malarien dhe sifilizin, që ishin evidente edhe më parë në këto anë, paraqisnin tragjedi të kohës.⁴⁶

Gjatë shekujve XIV dhe XV të gjitha epidemitë e murtajës vinin nga A. Vogël dhe kryesisht nëpërmjet detit. Prej atje i bartte në hinterland populli i ikur nga viset e infektuara bregdetare. Epidemia e murtajës linte pasoja fatale. Në tokat jugosllave kjo epidemi me përmasa të mëdha u shfaq në vitin 1348 dhe vatra e saj ishte Azia Lindore. Prej atje së pari u duk në Serbi, pastaj edhe në Raguzë. Në vitin 1362 epidemia e murtajës u duk përsëri dhe atëherë të ajo erdhi nga Trakia. Në vitin 1416 murtaja e kaploi përsëri Raguzën dhe la pas vetes pasoja të mëdha. Kroniku i kohës De Grade e quan »fuit maxima mortalitas«. Sipas Ragninit, kjo epidemi Raguzën e kaploi në vitin 1415 dhe zgjati dy muaj. Si pasojë vdiqën 30.800 të sëmurë. Nga një letër e qeverisë raguzane të vitit 1422, dërguar mbretit të Bosnjës, Tvrtko II, mësojmë se në këtë vit epidemia e murtajës e kaploi përsëri Raguzën. Epidemia në fjalë e kaploi Raguzën edhe në vitet 1428 dhe 1430, por me përmasa më të vogla. Epidemia e murtajës është dukur edhe në kolonitë raguzane dhe kështu në vitet 1456, 1457 dhe 1466, kur kishte kapluar ajo Raguzën, u duk edhe në Novobërdë.⁴⁷ Sipas mendimit tonë, ka të ngjarë që epideminë në fjalë

⁴³ A. Pazzini, *Storia delle Medicina I*, Milano 1947, 5; Ch. Singer, *Aschort historie of anatomy and physiology from the Greeks Harvey*, New York 1957, 34.

⁴⁴ J. Drançolli, *Shërbimi mjekësor në Kosovë*, 12.

⁴⁵ R. Katić, *Hilendarski medicinski kodeks br. 517*, Zbornik RIMI, SAN, LXXI; Sp. Đ. Radojčić, *Stare srpske povelje i rukopisne knjige*, *Arhivist II*, 2, 1952, 92.

⁴⁶ B. Bonado, *Viaggi a Constantinopoli*, Venezia, Ed., A. Polatti, 1688.

⁴⁷ S. Nodilo, *Annales Ragusini anonymi item Nicolai de Ragnina*, *Zagrabiae* 1883, f. 248; R. Katić, *Medicina kod Srba u srednjem veku*, SANU, Beograd 1958, 107—108.

gjatë viteve të përmendura në Raguzë ta kenë sjellë raguzanët e ikur nga disa koloni të veta, të cilat atëherë kishin rënë nën sundimin osman.

Është për t'u theksuar se njohuritë mjekësore për shërimet e epidemisë së murtajës gjatë periudhës mesjetare ishin të vogla. Parambrojtja më efikase për shpëtim nga kjo sëmundje ishte vetëm karantina. Masat e para në këtë drejtim u morën në Itali, përkatësisht në vitin 1374 Viskontiu mori vendim për themelimin e karantinave. Përveç në Itali, masa të këtilla u morën edhe në qytetet e bregdetit jugosllav, pra edhe në Raguzë dhe në kolonitë raguzane në hinterland.⁴⁸

Një sëmundje mjaft e përhapur në Gadishullin Ballkanik ishte lepra (në dokumentet e kohës — leproso). Në këtë ambient, sipas dokumenteve, lepra më evidente ishte sidomos pas ekspeditave të kryqtarëve (1096—1291). Studiuesit e mirënjohur jugosllavë R. Jeremiq dhe J. Tadic në studimin e vet *Prilozi za istoriju zdravstvene kulture starog Dubrovnika* (Kontribute për historinë e kulturës shëndetësore të Raguzës) japin të dhëna të hollësishme për sëmundjen e leprës në Raguzë. Nga rezultatet e tyre kërkimore fitohet përshtypja se komuna raguzane ka pasur kokëçarje të mëdha nga sëmundja në fjalë. Madje në vitin 1413 qeveria raguzane u detyrua të merrte vendimin që të sëmurët nga lepra ta linin qytetin. Masa identike u morën në Raguzë edhe në vitin 1438. Ndërkaq, në vitin 1463, për izolimin e të sëmurëve qeveria raguzane vendosi ta ndërtonte një shtëpi pranë detit.⁴⁹

Të sëmurët që lëngonin nga lepra përmenden edhe në Kosovë, përkatësisht mbreti Stefan Deçani në afërsi të Manastirit të Deçanit ngriti një vendstrehim për të sëmurët nga lepra.⁵⁰ Prania e të sëmurëve nga leproza vërehet edhe nga krisobula e shenjtërve Mihal dhe Gabriel, në të cilën thuhet se perandori Dushan i dhuroi këtij manastiri (1348—1353) edhe dy mullinj, »të cilët ishin pronë e Bogdan Gubavacit«.⁵¹

Për shërimin e sëmundjes së leprës, si në librat e mjekësisë raguzane, ashtu edhe në kodekset mjekësore serbe, bëhet fjalë shumë pak dhe nga kjo e dhënë mund të konstatohet se lepra ishte e pashërueshme për njohuritë mjekësore mesjetare.

Në kushtet e përgjithshme shëndetësore rol me rëndësi kanë pasur kushtet higjienike. Kur merret parasysh fakti se mundësitë shëruese në mesjetë ishin tepër të vogla, atëherë kushtet higjienike është dashur të kenë rol parësor për ruajtjen e shëndetësisë në përgjithësi. Megjithatë, rrugët e qyteteve kanë qenë përplot me qen të tërbuar, gurë dhe grumbuj mbeturinash, të cilat ndotnin pa masë ambientin e qyteteve. Faktor me rëndësi për ndotjen e qyteteve ishin edhe nevojtoret të pakanalizuara. Nga objektet e higjienës në qytetet e Kosovës mesjetare janë ruajtur cisternat

⁴⁸ A. Pazzini, *Storia delle Medizina I*, 54; J. Draçolli, *Shërbimi mjekësor në Kosovë*, 12.

⁴⁹ R. Katić, *Medicina kod Srba*, 116—117.

⁵⁰ R. Katić, *Medicina kod Srba*, 119.

⁵¹ St. Novaković, *Zakonski spomenici*, Beograd, 1912, 685.

për ujë në Prizren dhe në Novobërdë. Pamja arkitektonike e tyre ka qenë e afërt me ato të Raguzës dhe të Kotorrit.⁵²

Është karakteristike se si në Raguzë, ashtu edhe në Kosovë, spitalet u ndërtuan kryesisht pranë manastireve. Gjurmët e para të spitaleve mesjetare në Kosovë i gjejmë në shekullin XIV. Gjatë viteve 1327—1335 së pari u ndërtua spitali i Deçanit. Spitali në fjalë ishte pjesë përbërëse e Manastirit të Deçanit. Meqë kryemjeshtri, dom Vita, ishte nga Kotorri dhe kishte origjinë italiane, manastirin dhe spitalin ai i ndërtoi në frymën perëndimore. Sipas të dhënave të biografisë së Gregor Camblaku, në spitalin e Deçanit gjenin strehim të sëmurët nga epilepsia, tuberantët, reumatikët, leprotikët etj.⁵³

Spitali i Prizrenit u ngrit pranë Manastirit të Shenjtërve Mihal dhe Gabriel në vitin 1343. Nga një dokument vërehet se spitali kishte 20 shtrctër dhe ishte më i vogël se spitali i Deçanit dhe, ndryshe nga spitali i Deçanit, ku gjenin strehim edhe të varfërit, spitali i Prizrenit ishte institucion i karakterit shëruës.⁵⁴

Ndryshe nga spitalet e Deçanit dhe të Prizrenit, të cilat u ngritën pranë manastireve ortodokse, në Novobërdë spitali u ngrit pranë kishës katolike. Ndërkaq, në mirëmbajtjen dhe në financimin e tij merrnin pjesë kryesisht raguzanët.⁵⁵

Në shërbimin mjekësor të Kosovës mesjetare merrnin pjesë kryesisht mjekë me origjinë italianc, të cilët vinin këtu nëpërmjet Raguzës dhe Kotorrit. Mjeku i parë nga Kosova, i cili zihet ngoje në dokumente mesjetare, ishte njëfarë Milicinus de Presarin (Prizren) homo domini imperatoris. Nga deklarata e tij dërguar zyres raguzane, vërehet se është marrë me kirurgji. Sipas deklaratës në fjalë (të vitit 1349), Milicinus merr mbi vete detyrimin që ta shërojë birin e një këpucari raguzan për 20 perperë. Pacienti ishte i sëmurë nga morbis lapidis, qui dicitur malum de petra (guri në fshikëz).⁵⁶

Deri në shekullin XIV barnatoret ishin të rralla në Evropë, ndërkaq, në Kosovë ky asociacion mjekësor i takon një datë më të re. Gjatë mesjetës këtë profesion e ushtronin zakonisht mjekët, të cilët sillnin më vete njëkohësisht edhe medikamente mjekësore. Ka të ngjarë, mdonëse nuk ka ndonjë të dhënë, që barnatoret e para në Kosovë të kenë qenë në kuadrin e spitaleve. Përveç kësaj, me shitjen e barnave janë marrë edhe tregtarët që i sillnin këto

⁵² I. Sindik, *Komunalno uređenje Kotora, SAN, CLXV*, 1. Beograd, 1950, 57.

⁵³ L. Mirković, *Stare srpske biografije XV—XVII veka*, SKZ Beograd 1939, 23, 26; S. Ristić, *Dečanski spomenici*, Beograd 1864, 1—81; R. Katić, *Na kome se mestu nalazila Dečanska bolnica*, *Acta HMPHV I*, Beograd 1961, 182.

⁵⁴ R. Katić, *Medicina kod Srba u srednjem veku*, 172—173.

⁵⁵ HAD, *Testamenta Notariae XI*, f. 97 (më 10. I. 1424 — P. Siokievicq i lëalo spedal in Noumonte paro I a Oschorussa fossa ale glame); *XIII*, f. 53 (më 13. XI. 1439 — Ite, lasso allo hospedal de Noumonte duc 10); M. Dinić, *Za istoriju rudarstva II*, 95.

⁵⁶ R. Jeremić — J. Tadić, *Prilozi za istoriju zdravstvene kulture starog Dubrovnika II, Beograd*, 1939, 12.

nga Raguzi, Kotorri dhe nga ndonjë qytet tjetër perëndimor apo bizantin. Gjurmët e para të dokumentuara për zhvillimin e farmacistisë në Kosovë i ndeshim në vitin 1339 dhe 1340. Gjatë viteve të përmendura, mbreti Dushan ishte shtrirë i sëmurë në Prishtinë. Pos një mjeku raguzan, atë e vizitoi edhe farmaceuti i njohur Zanini.⁵⁷

Ndikimi i kulturës perëndimore, që vinte kryesisht nëpërmjet raguzanëve, në gjysmën e dytë të shekullit XV, kur qytetet e Kosovës ranë nën sundimin osman, zëvendësohet dalëngadalë nga ndikimi i kulturës osmane.

Në kolonitë e veta në Kosovë raguzanët organizonin edhe lojëra të ndryshme. Në këtë aspekt, raguzanët që vepronin në Novobërdë, zakonisht pranë qytetit bënin ushtrime në qitje me hark dhe me balistë dore (pro ludendo ad arcum et balistam 1413). Edhe sot në Dubrovnik një vend afër Piles, pranë detit, quhet »bersalia« (ital. bersaglio — poligon i qitjes). Në këtë vend është bërë qitja me hark dhe balistë që nga shekulli XIV.⁵⁸

Ndërkaq, në Prishtinë, për çdo vit organizohej njëfarë forme e qitjes në unazë. Kalorësit vinin me përgatitje komplete, me hark, shigjeta, shpatë dhe topuz. Pastaj kalorësit vraponin duke mbajtur shtizën në pozitë horizontale me qëllim që të ishin më efikas në heqjen e një dorëze që rrinte mbi një shatër. Me rastin e lojërave kushtuar kërsëndellave të vitit 1435, morën pjesë edhe bujarët raguzanë De Calich, De Gondola dhe De Lucari, pastaj qytetarë të Prishtinës, si dhe një bujar ulqinak me origjinë shqiptare (De Tani).⁵⁹

Nga një përshkrim i Filip de Diversisit, kronik raguzan, bëhet e ditur se edhe në Raguzë për çdo vit, me rastin e festës së shën Vllahut (më 3 shkurt) është bërë qitja në unazë. Ngadhënjente ai kalorës që arrinte t'i hiqte tri herë rrathët e varur në pozitë njëri pas tjetrit.⁶⁰

Përveç shprehjeve të shkëlqyera të paraqitura në shkrime të ndryshme, në jetën e përditshme të raguzanëve ndeshim edhe shargone dhe fyerje, si bie fjala, rrenacak, tradhtar, leprotik (leprose!), skllav, grua, gomar i ngordhur, bir lavireje, burrë lavireje etj. Fyerjet shoqëroheshin shpesh edhe me kërcënim të shkulljes së mjekrës, prerjes së hundës etj. Kështu, në vitin 1442, në Novobërdë, një raguzan iu kërcënua një tjetri, »Unë do të kujdesem që në qendër të Novobërdës të të rrjepin si dashin«. ⁶¹

⁵⁷ H. Tartalja, *Povijest farmacije*, Zagreb -952, 77, 81.

⁵⁸ K. Jireček, *Istorija Srba II*, 290.

⁵⁹ K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka I*, 413—416; autori i njëjtë, *Istorija Srba*, 292.

⁶⁰ Filip de Diversis, *Opis Dubrovnika*, Dubrovnik, 1983, f. 43—45.

⁶¹ K. Jireček, *Istorija Srba II*, 281.

3. Ndikimet religjioze

Dihet se e tërë popullsia e Kosovës para sundimit osman i takonte besimit të krishterë. Ky besim në këtë trevë është përhapur nëpërmjet dy qendrave, Romës dhe Kostandinopojës. Përveç kësaj, disa shekuj më parë në këtë anë apostulli Pal predikoi ungjillin.⁶²

Gjatë shekujve IV dhe V organizimi kishtar në Iliri mori hov aq të madh, sa që vetëm në Dardani u ngritën 5—7 peshkopata. Këto u organizuan sipas ndarjes administrative të Perandorisë Romake. Qendra e Kryepeshkopatës së Dardanisë para themelimit të Justiniana Prima, ishte Shkupi. Në kuadrin e saj hynte edhe Peshkopata Ulqiana (Lipjani i sotëm).⁶³ Është për t'u theksuar se peshkopatat e Dardanisë gjer në gjysmën e parë të shekullit XIII ishin në kuadrin e juridiksionit papal. Nga të dhënat e sipërme mund të konstatohet pa vështirësi se krishtërimin në trevën e Kosovës, si pjesë përbërëse e Dardanisë, deri në fillim të shekullit VIII, me ndërprerje edhe deri në shekullin XI, e kanë përhapur njerëzit e kulturës latine.

Ndikimi i kishës bizantine në Kosovë vërehet prej fillimit të shekullit XI, sidomos pas ndarjes së kishave (1054), në katolike (me qendër në Romë) dhe ortodokse (me qendër në Kostandinopojë). Në situatën e krijuar peshkopatat e Prizrenit, Hvosnës dhe e Lipjanit hynë në kuadrin e Kryepeshkopatës së Ohrit, e cila pas vitit 1018 ka pasur shtrirje në veri nga Danubi dhe Sava dhe në jug nëpërmjet vijës Sirmium — Rashë — Prizren deri në Durrës. Kufijtë e sipërmë, me disa zgjerime në perëndim tej këtij kufiri, ishin njëkohësisht edhe kufij të bizantit ortodoks.⁶⁴

Me zgjerimin e shtetit nemanjid në drejtim të jugut, nga fundi i shekullit XII dhe gjysma e parë e shekullit XIII, në kuadrin e tij hyri edhe Kosova. Atëbotë zgjerohet edhe kisha ortodokse serbe me të gjitha tiparet që kishte kisha ortodokse bizantine: ligjet bizantine, vepra të njohura teologjike, literaturë didaktike, art dhe zeje, me të cilat jeta kishtarë pasurohej me objekte të domosdoshme, nga arkitektura, piktura kishtarë deri veshjet e etërve dhe anët kishtarë.⁶⁵ Kisha ortodokse serbe deri në vitin 1219 ishte në juridiksionin e Kryepeshkopatës Autoqefale të Ohrit. Në këtë vit, me iniciativë të shën Savës, ajo u shpall e pavarur dhe selia e Kryepeshkopatës Serbe u bart në Pejë.⁶⁶ Me shpalljen e Perandorisë Serbe, në vitin 1346, Kryepeshkopata Serbe u ngrit në shkallë patriakane me seli në Pejë.⁶⁷

⁶² Z. Mirdita, *Iliri i etnogeneza Albanaca*, në *Iz istorije Albanaca*, Beograd 1969, 21.

⁶³ Z. Mirdita, *Iliri i etnogeneza Albanaca*, 21; autori i njëjtë, *Studime dardane*, Prishtinë, 1979, 134—141.

⁶⁴ K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka I*, 243, 247; S. Ćirković, *Susreti velikih civilizacija oko 1300*, JIC, 1975/1—2, 13; K. Kostić, *Naši novi gradovi na jugu*, 1; G. Buckler, *Anna Comnena*, Oxford at the Clarendon Press, 1929, 301—314.

⁶⁵ S. Ćirković, *Susreti velikih civilizacija oko 1300*, 16.

⁶⁶ K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka I*, 247.

⁶⁷ S. Novaković, *Zakonski spomenici*, 677; J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd 1950, 152.

Është për t'u theksuar se pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës gjatë shekujve XIV—XV i takonte besimit ortodoks. Këtij besimi i takonte edhe një pjesë e popullsisë shqiptare. Për përfaqsimin e ortodoksisë nga shqiptarët dëshmon më mirë përmendja në listat e banorëve, krahas klerikëve katolikë, të cilësuar me apelative që përdoren edhe sot në gjuhën shqipe: prift, dom, abat, edhe e klerikëve ortodoksë, të cilësuar si pop, papa, papas dhe kalogjer.⁶⁸

Në këtë kontekst shtrohet pyetja se ç'kishte ndodhur me ndikimin e kishës katolike në popullsinë e Kosovës mesjetare. Kisha serbe gjatë kohës së sundimit nemanjid, që nga themelimi, koordinoi politikën e vet me politikën e shtetit. Kleri i kishës ortodokse serbe në koncile të organizuar nga mbretërit serbë i jepte përkrahje pushtetit mbretëror. Kisha katolike, ndërkaq, ndonëse deri në fillim të shekullit XIV kishte pozitë të mirë në Serbi, prapëseprapë nuk kishte aq privilegje, sa zotëronte kleri ortodoks, sepse dihet se, sipas neneve 6, 7 dhe 8 të Kodit të Dushanit, denoheshin predikuesit e konfesionit katolik, përkatësisht, nëse prifti latin e kthente në »fenë« latine ndonjë të krishterë (këtu, më këtë term, mendohet vetëm për të krishterët ortodoksë), do të dënohej sipas ligjit të etërve të shenjtë.⁶⁹

Ndonëse kisha ortodokse serbe gjatë tërë kohës së sundimit nemanjid ishte faktor me rëndësi i jetës shtetërore, rol të theksuar në këtë drejtim mori në kohën e Perandorisë Serbe. Megjithatë, sunduesit e dinastisë nemanjide drejtonin sytë shpesh nga papati. Madje edhe vetë perandori Dushan, i cili, si u theksua më lart, ndaloi propagandën katolike, në disa raste bëri përpjekje të gjente mbështetje të papa. Përpjekje të tilla bënin edhe mbretit nemanjidë para Dushanit.⁷⁰ Po ashtu ka të dhëna edhe për dhurata të perandorit Dushan blotuar manastireve ose kishave latine, si, bie fjala, në fund të viteve tridhjetë të shekullit XIV, ai i dhuroi 100 perperë Manastirit të femrave Sancta Clara »monasterium pulcellarum« në Raguzë.⁷¹

Luftën për pavarësi në kuadrin e shtetit serb kisha katolike e filloi në formë më të theksuar me shpalljen e Kishës së Pavarur Ortodokse Serbe. Mirëpo, aktiviteti i kishës latine në këtë drejtim u kufizua kryesisht vetëm në ato vise bregdetare që ndodheshin në kuadrin e shtetit nemanjid. Me përmasa ca më të vogla kjo luftë u shtri edhe në Kosovë. Në këtë konstatim arrijmë kur merren parasysh relacionet e papatit me peshkopitë dhe famullitë

⁶⁸ *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës I*, Tiranë, 1974, 39—40; B. Hrabak, *Sveštena lica na Kosovu i u susednim krajevima 1455. godine*, *Buletini i punimeve shkencore të F. F. Prishtinës*, Prishtinë, 1972/IX, 68; St. Novaković, *Zakonski Spomenici*, 646—658, 682—701 (po në këtë përmbledhje në shumë vende).

⁶⁹ A. Solovjev, *Zakonik cara Stefana Dušana 1349 i 1354 godine*, Beograd, 1980, 174—177.

⁷⁰ A. Theinner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium I, Tipis Taticanis*, Roma 1863, në disa vende; B. Đurđev, *Uloga crkve u starijoj istoriji srpskog naroda*, Sarajevo 1964, 78.

⁷¹ K. Jireček, *Istorija Srba II*, 79.

katolike, të cilat vepronin në Kosovë. Sipas korrespondencës së papës Inocentii III (1198—1216) nga viti i shtatë i ngritjes së tij në selinë papale, përkatësisht nga viti 1204, në këtë aspekt zihet ngojë peshkopi katolik i Prizrenit (Prizrenensis) ose i Prishtinës (Pristinensis).⁷² Aksioni propagandues i papatit në Serbi mori hov në veçanti në gjysmën e parë të shekullit XIV. Lidhur me këtë, nga disa dokumente dalë nga zyra e papatit, njihemi me ekzistimin e famullive katolike në Kosovë dhe me relacionet e papatit me ato. Në dokumentin e papës Benedikti XI (1303—1306), shkruan në Lateran, më datën 8. XI. 1303, ndër pesë famullitë katolike në trojet e mbretërisë nemanjide, zihen ngoje edhe Famullia e Trepçës (De Trepzo) dhe e Graçanicës (De Grazaniza). Fjala është për famullinë e Janjevës.⁷³ Përmbajtje identike ka edhe dokumenti i papës Clementis VI (1342—1352) shkruar në Avinjon në vitin 1346. Në këtë dokument, si sufragan të dioqezës së Kotorrit, përmenden famullitë e Prizrenit, Novobërdës, Janjevës dhe Trepçës.⁷⁴ Ndërkaq, papa Urbani V (1362—1371), në vitin 1367, ndërmori një aksion të gjerë, të cilin e drejtoi kundër skizmës që kishte zënë rrënjë në Shqipëri dhe Serbi. Po ashtu bëri përpjekje që me ndihmën e misionarëve raguzanëve kotorras, durrësakë, venedikas etj., të realizonte union kishtar.⁷⁵

Propaganda dhe interesimi i papatit për trevën e Kosovës ishte aktiv edhe në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe në gjysmën e parë të shekullit XV. Në këtë aspekt, sipas një dokumenti që mban datën 12. V. 1404, dalë nga zyra e papatit, papa Bonifatius IX (1398—1404), në vendin e zbratur për peshkop në Peshkopatën e Prizrenit, zgjodhi rregulltar predikues Georgium Pandasiumin.⁷⁶ Paik më vonë, përkatësisht më 18. XII. 1431, papa Eugeni i IV (1432—1447) dërgoi raguzanin Ivan Stojkoviç në koncilin kishtar të Bezelit. Qëllimi i papës ishte përqëndruar që, nëpërmjet realizimit të unionit kishtar, ta përfitonte Serbinë dhe Bosnjën. Mirëpo, përpjekjet e kardinalit raguzan nuk sollën rezultat të dë-

⁷² A. Theinner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium I*, 29. — »praefuit anno 1204... humilis episcopus sanctissimi episcopatus Prisdiani Abraham...«; *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 76, nr. 3260 — »Hic primum nobis in fonte non ecclesiastico et in forma haud dubia aenigmaticus episcopus catholicus Pristenensis, cuius diocessis eadem esse videtur ac illa dicta Pristinensis, Prisdianensis, Prizriensis, Pissinensis«; Z. Mirđita, *Studime dardane*, 139.

⁷³ *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis I*, 147, nr. 149c — »anno 1303 in regne Srvie sequentes ecclesiae ritus enumerantur catolici:... de Trepzo et de Grazaniza«; I. Jastrebov, *Podaci za istoriju srpske crkve*, Beograd 1879; *Zbornik K. Jirečka I*, 261.

⁷⁴ *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis I*, f. 147, nr. 489c — »Anno 1346 Sergio episcopo Catharensi ecclesiae Serbiae quam plurimae adiuventur, inter quas Prisren, Novaberda, Trepza, Rudnich...«; në një dokument tjetër po të këtij viti zihet ngoje edhe Janjeva (Janeua) — shiko, *Zbornik K. Jirečka I*, 261; për dokumentin e papës Climentis VI, shkruar në Avinjon më 6. I. 1346, shiko, *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 4, nr. 20 dhe 20c; A. Theinner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium I*, f. 215.

⁷⁵ A. Theinner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium I*, 259.

⁷⁶ *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 230, nr. 270.

shiruar. Aktivitet të këtitillë në këtë kohë zhvilloi edhe humanisti i njohur Gjin Gazulli.⁷⁷

Nga sa u tha më lart shtrohet pyetja se çfarë ishte roli i raguzanëve në propagandën religjioze dhe sa patën ndikim ata në këtë aspekt në kolonitë e veta kosovare, meqë një trajtim të këtitillë e kërkon edhe problematika jonë.

Ndonëse që nga mesi i shekullit XIII, kur Kryepeshkopata Raguzane, pas luftës së gjatë me Kryepeshkopatën e Tivarit për mbizotërimin pësoi disfatë, dhe Tivari fitoi nga kuria e Romës rëndësinë si ruajtës katolik në kufirin midis dy besimeve,⁷⁸ raguzanët prapëseprapë gjatë shekujve XIV—XV patën rolin kryesor në propagandën katolike në Kosovë. Themi kështu meqë gjatë kësaj kohe raguzanët paraqitnin një numër të konsideruar të popullsisë qytetare në qytetet kosovare. Po ashtu kontaktet e tyre me popullsinë vendëse ishin të përditshme dhe kapnin fusha të ndryshme të veprimtarisë. Ndërkaq, në saje të interesimit të raguzanëve për jetën religjioze në kolonitë, ruhen të dhëna të mjaftueshme për zhvillimin e kishës katolike në Kosovë. Madje, nga rezultatet kërkimore të gjertanishme në këtë aspekt, konstatohet se në disa koloni raguzane në Kosovë, si, bie fjala, në Novobërdë, Janjevë, Prishtinë dhe Trepçë, ka shumë më tepër shënime për kishën katolike sesa për atë ortodokse.

Në mbështetje të materialit të shkruar e të ruajtur në arkivat e proveniencave perëndimore, në radhë të parë në arkivat e Dubrovnikut dhe të Kotorit, ndeshim të dhëna të mjaftueshme për veprimtarinë e një numri të konsiderueshëm famullish dhe kishash katolike në Kosovë, si, bie fjala, në Prizren i kemi të njohura Kishën e Shënmërisë (Sancta Maria de Prisren) dhe Kishën e shën Pjetrit (Sanctus Petrus supra Prisren),⁷⁹ në Prishtinë — Kisha e Shënmërisë,⁸⁰ në Janjevë — Kisha e shën Nikollës (San Nicola),⁸¹ në Novobërdë — Kisha e shën Nikollës (San Nicholo de Nouamonte) dhe Kisha e Shënmërisë (S. Maria in Dogni Terg),⁸²

⁷⁷ HAD, *Lettere et commissione Levantis XI*, f. 29—30, 167^v — 168^v; 178^v—179, 189^v—190; J. Tadić, *Johannes Gazulus Dubrovački humanista XV veka*, Zbornik F. S. Beograd 1964 / VIII—2, 435; J. Draçolli, *Gjin Gazulli — astronom dhe diplomat i shek. XV*, Prishtinë 1984, 25.

⁷⁸ M. Shufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë 1968, 168; St. Stanojević, *Borba za samostalnost kotoličke crkve u Nemanjičkoj državi*, SKA, Beograd, 1912, 72—156.

⁷⁹ A. Theinner, *Vetera monumenta Slavorum*, I, 215; *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis*, II, f. 4, nr. 20, 20c; K. Jireček, *Istorija Srba II*, 91, 94; J. Dedier, *Nova Srbija*, 256—257, dhe në shumë vende të HAD dhe HAK.

⁸⁰ D. Kovačević — Kojić, *Priština u srednjem veku*, 46, 64; HAD, *Testamenta Notariae*, në shumë vende; *Acta Consilii Minoris*, në shumë vende.

⁸¹ I. Jastrebov, *Podaci za istoriju srpske crkve*, 64; HAD, *Testamenta Notariae*, në shumë vende; *Acta Consilii Minoris*, në shumë vende.

⁸² *Acta et diplomata Res Albaniae*, I, f. 147, nr. 489c; II, f. 113, nr. 456, f. 228, 236, nr. 743, 764; M. Dinić, *Za istoriju rudarstva*, II, 92—95; HAD, *Testamenta Notariae*, në shumë vende, A. Cons. Min. në shumë vende.

dhe në Trepçë — Kisha e Shënmërisë dhe Kisha e shën Pjetrit.⁹³ Kishat e përmendura gjatë shekullit XIV dhe në gjysmën e parë të shekullit XV ishin kryesisht në kuadrin e Dioqezës së Kotorrës.

Është për t'u theksuar fakti se pjesën dërmuese të katolikëve në qytetet e Kosovës e përbënin në radhë të parë shqiptarët dhe raguzanët, pastaj sasët, kotorrasit dhe italianët.⁹⁴ Po ashtu një strukturë e këtillë përkatesie fetare vërehet edhe te priftërinjtë, të cilët shërbenin në Kosovë. Në këtë aspekt, sipas materialit që kemi, është me interes të zihet nga fakti, se edhe numri i priftërinjve shqiptarë, në krahasim me ata raguzanë, në famullitë dhe në kishat katolike në Kosovë, ishte më evident. Ky konstatim mund të thellohet edhe më derisa dihet se një numër i konsiderueshëm priftërinjsh që kishin hyrë në shërbim të zotit dhe vepronin në Raguzën mesjetare, kishin origjinë shqiptare.⁹⁵ Ka të ngjarë që ndonjë nga ata të ketë ardhur nga Ragusa për të shërbyer në Kosovë. Po ashtu në famullitë dhe kishat katolike vepronin edhe shqiptarë të ardhur nga qytetet e Adriatikut Jugor dhe nga Shqipëria Veriore. Mirëpo, numri më i madh i priftërinjve shqiptarë ishte nga qytetet e Kosovës. Këtë e ilustron në më së miri të dhënat për veprimtarinë e priftërinjve katolikë në Novobërdë, ose në ndonjë qytet tjetër të Kosovës, ku, sipas dokumentacionit që kemi, numri më i madh i tyre ishin shqiptarë, si, bie fjala, Presbiter Ginus filius Georgi de Nouaberda, Georgius Gega, dom Nicola Progonouich, Nicola de Tanus de Nouamonte, dompnus Ivanus plebanus Nouaberde.⁹⁶ Duke pasur konkurrencë të madhe nga priftërinjtë vendës dhe të huaj, interesimi i etërve kishtarë raguzanë për kolonitë në Kosovë nuk ishte aq i madh, siç ishte interesimi i bashkëqytetarëve të tyre tregtarë. Nga etërit raguzanë që shërbenin në Kosovë, numri më i madh vepronte në Novobërdë, si Pasquales de Bobalio (Dominus Pasqualis de Bobalio canonicus Ragusii et plebanus Nouimontis), Nicolaus de Vico pleban i Novobërdës, don Andrea de Nuouomonte, professor dominus magister Valerius de Nouomonte ordinis predicatorum (i ka takuar urdhrit dominikan), Andrea Bozhidareviq, Petar Çetronoviq, Dmtitar Gjurkoviq, Martin Plebanoviq, Nikola Gaiçiq etj.⁹⁷ Në Trepçë përmenden don Marko, don Ivani, don Marini etj.⁹⁸ Në Prishtinë, Marin »presbiter Pristine«, don Stjepko Radulinoviq, Don Nuksha Cetemanqiq, don Andrea Drinkashevq etj.⁹⁹ Në Janjevë,

⁹³ M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, 405; HAD, *Testamenta Notariae*, në shumë vende; *Acta Consilii Mihoris*, në shumë vende.

⁹⁴ K. Jireček, *Važnost Dubrovnika u trgovačkoj povijesti sr, vijeka*, 89; M. Dinić, *Srpske zemlje u sr. veku*, 333—334.

⁹⁵ J. Tadić, *Johannes Gazulus Dubrovački humanista*, 431.

⁹⁶ M. Dinić, *Za istoriju rudarstva, II*, 93; K. Jireček, *Istorija Srba II*, 404; HAD, *Diversa Cancellariae LXIX*, f. 23; *LXXI*, f. 104v; *LXXII*, f. 113; *Distributiones Testamentorum XI*, f. 263; *XV*, f. 15.

⁹⁷ HAD, *Distributiones testamentorum XIV*, f. 234; *Testamenta Notariae XV*, f. 11v; *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis, II*, f. 113, 228, 236, nr. 456, 743, 764; M. Dinić, *Za istoriju rudarstva, II*, 94.

⁹⁸ M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, 405.

⁹⁹ D. Kovačević, — Kojić, *Priština u srednjem veku*, 65; HAD, *Acta Cons, Minoris III*, f. 136v; *Testamenta Notariae XIV*, f. 123—123v.

presbit Andre (presbiter Andreas plebanus sancti Nicolai de Agneva).⁹⁰

Ndonëse numri i klerikëve raguzanë që vepronin në Kosovë nuk ishte i madh, prapëseprapë, kontributi dhe merita për zhvillimin e kishës katolike në Kosovë nga të huajt u takon në radhë të parë raguzanëve, përkatësisht bujarëve dhe qytetarëve raguzanë. Ata morën pjesë në financime për ndërtimin e kishave. Me rastin e përpilimit të testamenteve të veta, kishave, klerit dhe të varfërve katolikë u dhuronin pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme. Linin rregullisht një shumë për meshë. Nderkaq, bujarët e pasur u paguanin harxhimet klerikëve për pelegrinazh, si, bie fjala, në Kishën e shën Nikollës në Bari, Kishën e shën Pjetrit në Romë dhe në Kishën e shën Jakobit në Gadishullin e Pirineve.⁹¹ Mirëpo, ka pasur edhe pjesëtarë të klerit katolik kosovar, të cilët, me dhuratat e veta kontribuan në mënyrë të ndërsjellë në këtë a në atë mënyrë për përmirësimin e gjendjes financiare të kishës katolike raguzane. Në këtë aspekt duhet të përmendet rasti i atë Johannes nga Prizreni, i cili në testamentin e vet të përpiluar në vitin 1375 u lë françeskanëve në Ston katër libra.⁹²

Ndikimet raguzane në fushën religjioze në kolonitë e veta në Kosovë, pas rënies së kësaj treve nën sundimin osman, filluan të binin shpejt. Atëbotë shumë raguzanë i lanë kolonitë e veta në Kosovë. Me këtë valë të tërheqjes së popujve të detit u bashkua edhe një numër i madh i pjesëtarëve të klerit katolik vendës, si dhe i atyre të ardhur nga bregdeti dhe nga vende të tjera. Kësisoj, vetëm nga Novobërda, në Raguzë apo në trojet raguzane, tërhoqën këta pjesëtarë të klerit katolik: Presbyter Georgius de Nouamonte dictus Gega dhe Stephano de Radulino de Nouamonte, që të dy në Raguzë.⁹³ Don Nicola de Nouamonte plebanus in Grauosii (ne Gruz), don Nicola Progonouich de Nouamonte fuit capellanus in Grauosio⁹⁴ dhe frater Nicolaus de Nouamonte në Slano.⁹⁵

Pas rënies së Kosovës nën osmanët, filloi islamizimi i masave të këtushme, gjë që ndryshoi rrënjësisht strukturën në këtë trevë.

⁹⁰ HAD, *Diversa Cancellariae LV*, f. 139v.

⁹¹ D. Kovačević, — Kojić, *Priština u srednjem vijeku*, 64—65.

⁹² *Acta et diplomata Res Albaniae mediae aetatis II*, f. 76, nr. 322; M. Shufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, 196.

⁹³ M. Dinić, *Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni I*, 27; HAD, *Diversa Cancellariae LXVII*, f. 8 (1457); *LXXXII*, f. 106 (21. I. 1483).

⁹⁴ M. Dinić, *Za istoriju rudarstva, I*, 27; HAD, *Diversa Notariae XLV*, f. 42v, (4. III. 1463); *Diversa Cancellariae LXXXII*, f. 113 (21. V. 1462).

⁹⁵ M. Dinić, *Za istoriju rudarstva, I*, 27 (28. V. 1459).

Dr. Jahja Drançolli

L'INFLUENCES RECIPROQUES SOCIO-CULTURELLES ET RELIGIEUSES ENTRE RAGUSE ET LA KOSOVË PENDANT LE XIV ET LE XV SIECLE

R é s u m é

Depuis l'antiquité et même dans des périodes postérieures historiques, le territoire actuel de la Province Autonome Socialiste de Kosove se trouve au carrefour des migrations et des influences de diverses régions. Une telle situation de Kosovë pendant le féodalisme développé, et le fait fit que Kosova fut une des régions plus fécondes de la Péninsule balkanique, où les commerçants de la commune de la République de Raguse montrèrent un intérêt pour les richesses de la Kosovë.

Pendant le féodalisme développé, la Kosovë faisait partie intégrale aux régions du Royaume des Némanides. Après 1371, la région en question par des chefs locaux eut des contacts incessants avec des citoyens et villes ragusiens. Les villes de Kosovë qui faisaient ces contacts étaient: Janjvë, Novobërda, Peja, Prishtina, Prizreni, Trepca et d'autres.

Sauf l'importance économique-commerciale, il y avait aussi des influences dans des domaines socio-culturels et religieuses.

Cette influence se reflète dans toute une création culturelle des villes moyennageuses de la Kosovë, premièrement dans des arts (architecture, sculpture et peinture), médecine, lexique etc. Dans quelques moments historiques, tout d'abord, par les ragusiens se sentit l'esprit idéologique occidental, à priori, sous forme de la religion, notamment de la forme de l'influence de l'église et du dogme catholique.